



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 232/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani Kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) me seli në Prizren, për shkak të dëmtimit të posterëve në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Hidhet poshtë si e pa rregullt ankesa e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) me seli në Prizren .

Arsyetim

Me datën 07.06.2014, subjekti politik KDTP, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se subjekti politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) ka vendosur posterin e kandidatës për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës Hurmet Celina, mbi posterin e kandidatit Levent Bus nga radhët e subjektit KDTP.

Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj rregullsinë e ankesës gjeti se:

ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se ankesa është e parregullt sepse parashtruesi i ankesës nuk e ka specifikuar datën kohen dhe vendin e shkeljes së pretenduar , ashtu siç kërkohet në bazë të nenin 3 par.6 pikat (b), dhe neni 3 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në shqyrtimin e kësaj çështje, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuar andaj bazuar na dispozitat e theksuar më lart si dhe në arsyet e sipërshënuar po ashtu në kuptim të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr.232/2014 më datën 08.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*